

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	'Ballkani është fuçi baruti'/ Kongresmeni amerikan apel Hagës: Drejtësia të mos ndikohet nga politika
ADRESA	https://boldnews.al/2026/09/15/ballkani-eshte-fuci-baruti-kongresmeni-amerikan-apel-hage-s-drejtesia-te-mos-ndikohet-nga-politika/
BURIMI	boldnews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 13:59:31 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 13:58:44 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	5da7c45a5769b4bb278e1ff755982de947071905e5e6296cc3c6896666a991c1
TEKSTI	4c1b862d7197ebdc8953b33f2f4d0bf67def6a7e1ce7ef5deda72959f8bbdba6
PAMJA	bc048c88a657313f5077b6d82ce1b759e08a6ca628d9de71ddd5365b860d9309

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	05469ce04a89f03d13295a9cd5773630929eb260c7d439f81a209e62566734a9
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	30dbb60d3d02cfc881d14f9729132b5faa86f341ad579020b2892f9612d800a7
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/05469ce04a89f03d13295a9cd5773630929eb260c7d439f81a209e62566734a9>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Fillimi > RAJONI

'Ballkani është fuçi baruti'/ Kongresmeni amerikan apel Hagës: Drejtësia të mos ndikohet nga politika

15:58 : 15/09/2026 në RAJONI



Kongresmeni amerikan Keith Self ka reaguar në prag të një vendimi të rëndësishëm në procesin gjyqësor ndaj Hashim Thaçit dhe tre ish-drejtuesve të tjerë të UÇK-së në Hagë, duke ngritur shqetësime për ndikimin që politika mund të ketë në vendimmarrjen gjyqësore.

Përmes një reagimi të publikuar në platformën X, ligjvënësi amerikan bëri thirrje që çështja të trajtohet pa paragjykimet politike, ndërsa e lidhi rëndësinë e procesit edhe me situatën e brishtë në Ballkan.

Self pretendon se në çështje të ndryshme të trajtuara në Hagë është vënë re një tendencë që konsideratat politike të ndikojnë në vendime.

Ai shprehu shpresën që një gjë e tillë të mos ndodhë edhe në procesin ndaj ish-presidentit të Kosovës dhe tre të akuzuarve të tjerë.

Kongresmeni amerikan iu referua Thaçit dhe bashkëluftëtarëve të tij si shqiptarë që luftuan për pavarësinë pas viteve të shtypjes nga Serbia.

Lexo edhe:

[Vazhdon seanca në Hagë ndaj ish-krerëve të UÇK-së, palët japin sot përgjigjet përfundimtare](#)[Prokuroria në Hagë kërkon 6 vjet burgim për Hashim Thaçin](#)

Në reagimin e tij, Self paralajmëroi gjithashtu për pasojat që tensionet e reja mund të kenë në rajon, duke e cilësuar Ballkanin si një "fuçi baruti".

Sipas tij, ekzistojnë regjime shtypëse që mund të përfitojnë nga përçarjet dhe tensionet në rajon, në vend që të kontribuojnë në procesin e pajtimit.

Deklarata e kongresmenit amerikan vjen ndërsa vëmendja është përqendruar te zhvillimet në Hagë dhe procesi ndaj Hashim Thaçit dhe tre ish-krerëve të tjerë të UÇK-së.

Etiketa: [hagë](#) [Keith Self](#)

TË GJITHA



Nga Brazili, përmes Marokut e Greqisë/ Si arriti kontejneri me kokainë në Durrës, asnjë i arrestuar

15:58 : 15/09/2026



'Ballkani është fuçi baruti'/ Kongresmeni amerikan apel Hagës: Drejtësia të mos ndikohet nga politika

15:58 : 15/09/2026



Wifi dhe alkool/ SPAK aksion blic në sektorin ku mbahet Ergys Agasi

15:47 : 15/09/2026



Vendimi i Gjykatës së Lartë për Veliain, Rama: E lanë Tiranën pa kokë!

15:43 : 15/09/2026



Protestat kundër Ramës në Tiranë/ Ambasadori kroat: Qeveria duhet të dëgjojë mesazhin

15:28 : 15/09/2026



12 vende të BE-së kërkojnë "blindimin" e Arktikut kundër kërcënimit rus

15:27 : 15/09/2026



Lali dhe zyra xixë e kollandrisur nga drejtorët e tij

15:04 : 15/09/2026



Vazhdon seanca në Hagë ndaj ish-krerëve të UÇK-së, palët japin sot përgjigjet përfundimtare

09:20 : 14/09/2026



Prokuroria në Hagë kërkon 6 vjet burgim për Hashim Thaçin

14:27 : 10/09/2026



Nëse Thaçi shpallet i pafajshëm, a lirohet menjëherë?

15:50 : 21/08/2026



Refuzohet garancia 50 mijë euro, Hashim Thaçi mbetet në paraburgim

13:49 : 03/08/2026



Çështja e detit në Hagë, Rama kërkon fundin e historisë jo fitoren e Shqipërisë

16:41 : 02/08/2026



REL: Më shumë se një verdikt për katër ish-krerët e UÇK-së

12:33 : 28/06/2026



RRETH NESH

Boldnews.al mbetet zgjedhja e parë për një lexues i cili kërkon të informohet me saktësi për një lajm. Misioni jonë kryesor është paanshëmëria dhe profesionalizmi dhe për këtë janë të punësuar gazetarët më të mirë në tregun mediatik.
Na kontakto:

NA NDIQ

